

## SHKALLËT E BESIMTARËVE NË RRUGËTIMIN DREJT ALLAHUT (MEDAARIXH ES-SAALIKIIN)

---

### Dëshmimi / *el-Mushaahede* / الْمُشَاهَدَةُ

Dr. Hatim el-Haxh

Materiali është përmbledhje e kuptimeve të audio-ligjëratës

<https://buff.ly/2hbVv4T>

Allahu ﷻ tha:

"إِنَّ فِي ذَلِكَ لَذِكْرَى لِمَنْ كَانَ لَهُ قَلْبٌ أَوْ أَلْقَى السَّمْعَ وَهُوَ شَهِيدٌ"

“Vërtet me këtë kujtohet ai që ka zemër, dëshiron të dëgjojë, dhe është vazhdimisht dëshmues (i së vërtetës).” (Kaf, 37)

Dëshmimi është rënie e plotë e perdes. Kjo është mbi zbulimin (*mukaashefe*), sepse zbulimi ka të bëjë me atributet, prandaj dhe ka disa mbetje imazhesh<sup>1</sup>; kurse zbulimi ka të bëjë me qenien hyjnore (*dhaat*)<sup>2</sup>. Kjo ka tri nivele:

Niveli i parë është dëshmimi me *ma'rife* (njohje)<sup>3</sup>, i cili tejkalon kufijtë e dijes<sup>4</sup> në pllakat e dritës së realizimit<sup>5</sup>, duke bërë që kafsha kalëruese e tij (ndjekësit) të gjunjëzohet në oborin e bashkimit (*xhem*).

---

<sup>1</sup> Meqenëse emrat dhe cilësitë (e Allahut) manifestohen në ekzistencë dhe në dukuritë e përkohshme, të cilat janë imazhe që mbulojnë realitetin.

<sup>2</sup> Imam Ibn el-Kajjim thekson në *Medaarixh* se perceptimi i qenies (*dhaat*) së Allahut, që përshkruhet nga të gjitha atributet e përsosurisë dhe të madhësisë, është mënyra e peygamberëve dhe e të Dërguarve të cilët nuk u orvatën t'ia heqin qenies (*dhaat*) atributet ose t'i shohin atributet si të izoluara nga qenia (*dhaat*), gjë që, nga ana ontologjike, është e pamundur. Mirëpo, të shohësh disa nga atributet dhe jo të gjitha është diçka inferiore në krahasim me perceptimin ku përfshihen të gjitha atributet. Në fund, të parët e manifestimeve të ndryshme të attributeve, si manifestimet e fuqisë ose të mëshirës së Tij në ekzistencën e përkohshme, nuk duhet të të shpërqendrojë nga të shikuarit e Tij dhe të njësisë së Tij.

<sup>3</sup> Dija e dobishme e zemrës, jo thjesht vetëm dija teknike e intelektit.

<sup>4</sup> Farat e dijes presin ujin e njohjes për të nxjerrë frytet e devocionit dhe realizimin e plotë. Përvojat shpirtërore plotësojnë dijen e nuk e zëvendësojnë.

<sup>5</sup> Realizimi i të kuptuarit dhe devocionit.

Niveli i dytë është dëshmimi me sy, i cili pret litarët e shenjave treguese<sup>6</sup>, mbart atributet e shenjtërisë<sup>7</sup>, dhe hesht gjuhët e simbolikës<sup>8</sup>.

Niveli i tretë është dëshmimi i *xhem'*, i cili e tërheq drejt vendit të bashkimit me siguri/bindje për arritjen<sup>9</sup>, duke lundruar oqeanin e realizimit të plotë<sup>10</sup>.

---

<sup>6</sup> Shenjat treguese për tek Allahu u ngjasuan me litarë që tërheqin robin drejt Tij, kështu që, kur ai arrin Atë, litarët nuk i duhen më.

<sup>7</sup> Atributet e mira që Allahu do t'i dhurojë atij. Kurse këto nuk janë atributet e vetë hyjnore, rekomandohet që të ndiqen manifestimet njerëzore të attributeve të Tij aty ku kjo është e përshtatshme, siç është butësia, mëshira, dhe bujaria. Atributet e Tija të madhështisë janë vetëm të Tijat. Ka dhe attribute të mira për njerëzit të cilat nuk i kanë hije Zotit, siç është përulësia, thyerja, dhe nevoja/varfëria.

<sup>8</sup> S'ka më tregim drejtimi pas realizimit.

<sup>9</sup> Besimi i plotë për rrugën dhe vendmbërritjen.

<sup>10</sup> Të qenët pa veten (egon), i tëri për Zotin, me Zotin, pranë Zotit, ku Zoti bëhet të dëgjuarit me të cilin ai dëgjon, të parët me të cilët ai sheh, dorë e tij me të cilën godet, dhe këmbë e tij me të cilën ecën.